

**RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË SHKOLLËN SHQIPTARE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE
(ASPA)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit në ASPA, bazohet në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në VKM nr. 874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”, Udhëzim nr.1, datë 27.06.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave, në institucionet publike”, dhe aktet nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre.

Neni 2

Përkufizime

1. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.
2. Eprorët e zyrtarëve në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), sipas hierarkisë, brenda institucionit të ASPA-s janë: Drejtor i ASPA-s dhe Drejtor Drejtorie.
3. "Institucion epror" për ASPA-n është Kryeministria. Roli “epror” ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve qendrore.
4. "Person i lidhur me një zyrtar të ASPA-s" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, me zyrtarin sipas përcaktimit të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
5. "Parim i proporcionalitetit" (sipas nenit 12, të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar), është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave të një zyrtari të ASPA-s me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave veti.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

1. Çdo zyrtar i ASPA-s, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron

- kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
2. Çdo zyrtar i ASPA-s, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për akte dhe kontrata administrative;
 3. Çdo zyrtar i ASPA-s, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte;
 4. Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 4

Çastet paraprake të vendimarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a) vendimarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:
 - i) hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimarrje;
 - ii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;
 - iii) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;
 - iv) dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;
 - v) përfshirjen e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetej përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projekt-kontratës në tërësinë e tyre;
 - vi) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së ASPA-s.

Neni 5

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i ASPA-s, ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimarrjen për këtë akt, sipas nenit 4 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet

paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

- a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;
 - b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht me të dhëna sensitive për subjektet dhe ose ish-subjektet e ASPA-s, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikat ekonomike qeveritare dhe administrimin financiar;
 - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të ASPA-s:
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i ASPA-s, i emëruar si i tillë nga Drejtori i ASPA-s, si dhe nga zyrtarët-eprorë në ASPA.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.
5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pikës 2 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.
6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 6

Interesat privatë

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa që parashikon neni 5 i ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, e konkretisht:
 - a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
 - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
 - c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
 - ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
 - d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
- dh) marrëdhënie:
 - i) familjare apo të bashkëjetesës;
 - ii) të komunitetit;

iii) etnike;

iv) fetare;

v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;

d) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KONFLIKTEVE RAST PAS RASTI TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve rast për rast të interesave

Neni 7

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i ASPA-s, sipas përcaktimit të këtij termi në pikat 1 e 2, të nenit 2 të kësaj rregulloreje, që përgatit raportet për kontroll të plotë në verifikimin e deklaratave të interesave private periodike të subjekteve të ASPA-s, që mbikqyrin ose përdorin fonde publike, që lidhin kontrata shërbimi, investimi, që përfaqësojnë ASPA-n, në marrëdhënie me të tretët, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tyre funksionale ose të ngarkuara përkohësisht, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat, që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari kur kjo kërkohet nga Eprori ose institucioni Epror. Deklarimi, si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari ose punonjësi përfshihet në një vendimarrje për një akt dhe/ose për subjekte të deklarimit periodik të interesave private në ASPA.
4. Drejtori i ASPA, me mbështetjen e Autoritetit Përgjegjës në ASPA dhe në bazë të vetdeklarimit të zyrtarit të ASPA-së, si dhe në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmangë emërimin e një zyrtari në pozicione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash. Inspektori i Përgjithshëm merr masa që zyrtarit të mos t'i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash dhe në rast të kundërt mer masa për largimin e zyrtarit nga detyra.

Neni 8

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit në ASPA, është:
detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
 - a) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, qe ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
 - b) Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari dhe punonjësi të ASPA, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 9

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari i ASPA-s

1. ASPA vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, në formë e në përmbajtje, që këta duhet të lëshojnë.
2. Autorizimi dorëzohet pranë Autoritetit Përgjegjës në ASPA brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.

Neni 10

Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji nga funksionarët e ASPA është ILDKPKI
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji sipas hierarkisë në ASPA janë:
 - a) Drejtori i ASPA
 - b) Drejtorët e Drejtorive
 - c) Përgjegjësi i sektorit
 - d) Çdo zyrtar tjetër sipas përcaktimit të nenit 4, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 11

Detyrat e Autoritetit Përgjegjës

Autoriteti Përgjegjës i ASPA-s, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) mbledh dhe dokumenton interesat private të zyrtarëve të ASPA-s;
- b) shpërndan dhe mbledh autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët e ASPA-s, sipas nenit 10 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- c) krijon regjistrin përkatës dhe mban regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
- ç) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të ASPA-s, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
 - i) konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
 - ii) konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) kryen me autorizim të Drejtorit të ASPA-s, verifikim të interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve dhe punonjësve të këtij institucioni, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit Inspektorin e Përgjithshëm;
- dh) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- i) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimeve të tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- ë) merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
- f) në bashkëpunim me Drejtorinë e ASPA-s:
 - i) marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin ASPA-s në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit të zyrtarët përgjegjës;
 - ii) orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të ASPA-s, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm;
 - iii) shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Inspektori i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij ligji, si dhe për përmirësime në ligje të tjera kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
- iv) marrin masa për të miratuar në rregulloret e brendshme të ASPA-s, udhëzimet e orientimet e lëshuara nga Kuvendi i RSH-së, si dhe nga Inspektori i Përgjithshëm;
- g) mbështet Drejtorin e ASPA-s në kryerjen e deklarimit periodik të interesave nga zyrtarët e ASPA-s;
- gj) bën me dije zyrtarët dhe punonjësit e ASPA-s për çdo këshillë apo udhëzim të Kryeministrit dhe ILDKPKI-së;
- h) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të

ASPA-s për zyrtarët e këtij institucioni;

- i) ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të Drejtorit të ASPA-s.

Neni 12

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të ASPA-s - së, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga Autoriteti Përgjegjës i ASPA-s

Neni 13

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti përgjegjës i ASPA-s për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të ASPA-s, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet epror, ose nga gjykatat.

Seksioni 2

Identifikimi dhe regjistrimi periodik i interesave privatë

Neni 14

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave privatë

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të ASPA-s bëhet në përputhje kërkesave të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e ASPA-s, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklaram të interesave private periodike janë:
 - a) Drejtori i ASPA-s;
 - b) Drejtorët e Drejtorive;
3. Gjithashtu, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklaram të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të ASPA-s, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.
4. Çdo zyrtar i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni dhe Konfliktit të Interesit, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në ASPA, ose kur kalon në një pozicion që nuk mbart detyrimin për deklaram, është i detyruar, që brenda 15 ditëve nga data e largimit nga funksioni, të plotësojë

dokumentin zyrtar “Deklaratë pas largimit nga funksioni”. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, nuk mund të bëjnë dorëzimin e librezës së punës, të çdo dokumenti tjetër, si dhe pagimin e pagës së fundit dhe/ose shpërblimeve që mund t’i takojnë zyrtarit, në rast se ky i fundit nuk plotëson këtë detyrim ligjor.

Neni 15

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e ASPA-s, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:
 - a) zyrtari i ASPA-s, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues (qofte ky dhe subjekt i ASPA-s), dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;
 - b) kur marrja e masës ndaj shtetasit që informon përcaktohet nga një shkak tjetër ligjor, ajo merret vetëm nga një zyrtar tjetër i ASPA-s, që qëndron në marrëdhënie varësie vertikale mbi zyrtarin, për të cilin është dhënë informacioni.
2. Nga parashikimi i pikës 1 (b) të këtij neni bën përjashtim rasti kur marrja e masës administrative bëhet në kushtet kur konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm i zyrtarit të ASPA-s, është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) kur zyrtari i ASPA-s, është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
 - b) kur vetëpërjashtimi i zyrtarit është i pamundur, sepse është e pamundur delegimi i kompetencave të tij tek një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës;
 - c) kur vendimet e zyrtarit të ASPA-s, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;
 - d) kur nuk është i mundur transferimi a tjetërsimi i interesit privat, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.)
 - e) kur nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, zyrtari i ASPA-s, të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga Eprori ose Institucioni Epror të ngarkuar me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 16

Ndalimi i lidhjes së kontratave

1. Zbatohet Kreu III, seksioni 1, nenet 21 e 22 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 për përcaktimin e kategorive të zyrtarëve dhe llojet e kufizimeve të interesave private për të parandaluar konfliktin rast për rast të interesave për raste të veçanta.
2. Drejtori i ASPA-s dhe Drejtorët e Drejtorive dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, kur këta zyrtarë zotërojnë në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në cfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë osë nënkontratë me asnjë institucion public në fushën e

territorit dhe të juridiksionit të ASPA-s. Ky ndalim zbatohet dhe kur palë është një institucion i varësisë.

3. Ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;

b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative, apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij neni.

4. Nga ndalimet e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës:

a) ka të bëjë me punësimin e vetë zyrtarit në institucion publik ose me statusin e tij ligjor;

b) ka të bëjë me marrjen nga zyrtari të një shërbimi, që ofrohet nga institucioni publik ose organizmat dhe subjektet e krijuara a nën kontrollin e institucionit publik, kur këto shërbime janë të parashikuara në objektin e veprimtarisë së institucionit publik, si dhe me kushtin që shërbimi nuk i jepet zyrtarit në mënyrë favorizuese apo si trajtim preferencial në raport me të tjerët;

c) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike, ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve;

ç) është e domosdoshme për kryerjen e funksionit publik dhe nuk ka alternativë tjetër;

d) ka të bëjë me një dhuratë, favor ose trajtim preferencial, në çdo rast pa kundërshtim, që subjektet e përcaktuara bëjnë në favor të një institucioni publik.

5. Për rastin përjashtimor të shkronjës “ç” të pikës 4 të këtij neni, institucioni publik, që lidh kontratën, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e tij:

a) kërkon pëlqimin e institucionit më të afërt epror;

b) njofton Inspektoratin e Lartë dhe e bën këtë kontratë publike në mungesë të institucionit apo kur marrja e pëlqimit bie ndesh me parimin e pavarësisë së institucioneve.

6. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, bashkëshorti/ja, femijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe bashkëshortit/es, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 17

Ndalime në sigurimin e të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë

1. I ndalohet që të zotërojë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital, si dhe çdo lloj përfitimi tjetër, që nuk buron nga zotërimi pasiv, nga shoqëritë tregtare, që janë të përjashtuara ose të lehtësuara nga detyrimet doganore ose tatimore, si dhe kur këto shoqëri ushtrojnë veprimtari në zonat e lira, çdo zyrtari që ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në dhënien shoqërisë të secilit prej trajtimeve të sipërpërmendura.

2. I ndalohet që të zotërojë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital, si dhe çdo lloj përfitimi tjetër, që nuk buron nga zotërimi pasiv, nga shoqëritë tregtare, që janë të përjashtuara ose të lehtësuara nga detyrimet doganore ose tatimore, si dhe kur këto shoqëri ushtrojnë veprimtari në zonat e lira, çdo zyrtari që ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në dhënien shoqërisë të secilit prej trajtimeve të sipërpërmendura.
3. Zyrtarit, që është përfaqësues i një institucioni publik në zotërimin e aksioneve ose të pjesëve në kapital të shoqërive tregtare, gjatë ushtrimit të këtij funksioni i ndalohet:
 - a) marrja drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, e çdo përfitimi financiar, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet ose përfitohet për shkak të detyrës së tij si përfaqësues;
 - b) pranimi, në favor të tij, i dhuratave ose pjesëve në kapital nga shoqëria, anëtarët ose organet e saj;
 - c) blerja e pjesëve në kapital, aksioneve ose pasurive të këtyre shoqërive;
 - ç) përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues apo klientë të këtyre shoqërive.

Neni 18

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. “Dhurata”, sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në Vendim nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”
2. Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë apo të pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, familjen, të afërmit, personat fizikë apo juridikë me të cilët ka marrëdhënie:
 - a) dhurata, favore, pritje apo çdo përfitim tjetër, si dhe premtime për to, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, a janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës;
 - b) ftesa për pritje të ndryshme, premtime, ofrime falas apo ulje të çmimeve për kryerjen e shërbimeve, të argëtimeve, pushimeve, transporteve, udhëtimeve;
 - c) përfitime të bursave të studimit dhe/apo të sigurimeve.
3. Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një nëpunës të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga nëpunës i një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
4. Një dhuratë konsiderohet e marrë në mënyrë të tërthortë kur i jepet familjes së nëpunësit, të afërmeve, deri në shkallën e dytë, personave ose organizatave, me të cilat nëpunësi ka pasur ose ka marrëdhënie biznesi ose lidhje politike, në bazë të kërkesës, rekomandimit apo udhëzimit të nëpunësit.
5. Rregullat e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni, nuk zbatohen në rastin e ftesave të

zakonshme apo kur janë të ftuar nëpunës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve, lidhjes farefisnore dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.

6. Nëpunësi i administratës publike mund të pranojë dhurata nga qeveritë e huaja apo organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, kortsizisë apo protokollit, nëse nuk tejkalohen kufijtë e traditës e të zakoneve të vendit ku jepen, nuk vënë në dyshim objektivitetin, ndershmërinë dhe paanshmërinë e nëpunësit e nëse nuk kompromentojnë imazhin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë.
7. Nëpunësi i administratës publike mund të mbajë dhurata të lejueshme, pa qenë i detyruar t'i deklarojë ato, nëse nuk e kalojnë vlerën prej 10 000 (dhjetëmijë) lekësh për dhuratë. Nëse nëpunësi ka dyshim për vlerën e dhuratës, ai njofton eprorin direkt dhe i kërkon njësisë së burimeve njerëzore të kryejë vlerësimin e saj.
8. Dhuratat e pranuar nga nëpunësi i administratës publike nga delegacione të çfarëdo natyre apo individë, mbi vlerën e caktuar, për shkak të pozicionit të tij, duhet të deklarohen brenda 30 (tridhjetë) ditëve tek eprorët, si dhe në njësinë e shërbimeve mbështetëse.
9. Njësia e burimeve njerëzore bën vlerësimin e dhuratave dhe inventarizon ato me vlerë më të madhe se 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Dhuratat administrohen në një vend të posaçëm dhe ato mund të përdoren për qëllime të veprimtarisë institucionale.
10. Dhuratat, që kanë vlera artistike, muzeore apo historike, u dorëzohen institucioneve të specializuara. Në të njëjtën mënyrë administrohen edhe dhuratat që nuk mund të kthehen, sipas ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", i ndryshuar.
11. Në asnjë rast, nëpunësi nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
12. Në rast se nëpunësi i administratës publike dëshiron të mbajë dhuratën me vlerë mbi 10 000 (dhjetë mijë) lekë, atëherë ai paguan diferencën e vlerës së saj, pas vlerësimit të bërë nga institucioni.
13. Janë të ndaluara të gjitha dhuratat, që çojnë në konflikt interesi sipas legjislacionit në këtë fushë, pavarësisht vlerës së tyre.
14. Nëpunësi i administratës publike nuk merr përsipër dhe as bën premtime, lidhur me kryerjen ose moskryerjen e veprimeve administrative në kompetencë të tij ose të kolegëve, që mund të përbëjnë shkak për njëanshmëri gjatë ushtrimit të detyrave.

Neni 19

Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e ASPA-s, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 16 e 18 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
 - a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
 - b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e ASPA-s, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
3. Përsa i përket kufijve të zotërimit të aksioneve ose të pjesëve në kapital, për zyrtarin e ASPA-s dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtëpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.
4. Personi i lidhur me zyrtarin e ASPA-s, nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit të ASPA-s dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet kushti i mëposhtëm:
 - a) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin e parashikuar nga ligji.

Neni 20

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave për zyrtarët/ punonjësit e ASPA-s bëhen sipas kreut IV të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 21

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të ASPA-s, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 22

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.
2. Rregullorja e mëparshme dhe aktet që lidhen me të shfuqizohen.

Aneks nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(Emërtimi i institucionit)

Nr. _____ Prot.

(Qyteti) më, ____/____/____

A U T O R I Z I M

Unë, i nënshkruari, _____
(emër, atësi, mbiemër)
me funksion _____

(emërtimi i funksionit dhe institucionit publik)

në datën ____/____/____, në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10 pika 2 dhe nenit 41 pika 2 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", autorizoj institucionin:

(emërtimi i institucionit publik ose i institucionit epror sipas pikës 10 të nenit 3 të ligjit nr.9367)
që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave private të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave personale të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të këtij ligji. Ky autorizim ka të njëjtën vlerë edhe për çdo institucion epror.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushtroj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mia private, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna personale, të kryera nga institucionet, ose personat e autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t'u nxjerrë pengesë personave konkretë që posedojnë origjinalin ose kopjen e njehsuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht, sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mia private. Në bazë të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" I ndryshuar, personi i ngarkuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, që vihet në dijeni për të dhënat personale të autorizuesit, detyrohet të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

AUTORIZUESI

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

TITULLARI I INSTITUCIONIT
(OSE I INSTITUCIONIT EPROR)

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

(Vula e institucionit)

D E K L A R I M
RAST PAS RASTI I INTERESAVE PRIVATE TË ZYRTARIT
NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Kush mbart detyrimin për deklaram rast për rast të interesave private:

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Llojet e deklaramit:

1- Vetdeklarim paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesave private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi

2- Deklarim rast për rast të interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

Të dhëna personale:

-Emri	- Atësia	- Mbiemri	- Funksioni	- Institucioni
-------	----------	-----------	-------------	----------------

Lloji i deklaramit: (vendos X në kutizën për llojin e deklaramit)

☐ Me kërkesë të _____

☐ Vetdeklarim

Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vertetësinë e tyre.

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaratës

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Aneks Nr. 3

Republika e Shqipërisë

Institucioni _____

Datë __ / __ / ____

**REGJISTRI VJETOR I EVIDENTIMIT DHE ZGJIDHJES SË RASTEVE TË KONFLIKTIT
TË INTERESAVE**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Funksioni	Data e evidentimit	Përshkrimi i Konfliktit të Interesit	Burimi i të dhënave dhe verifikimi	Mënyra dhe data e zgjidhjes së konfliktit	Shënime

Shënim: Ky regjistër është pjesë e raportit vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në të cilën duhet të evidentohen rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarinin periodik. Sqarimet në lidhje me rastet e konflikteve të interesave të detajohen në raportin vjetor të Autoritetit Përgjegjës.

Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave duhet të dërgohet i plotësuar në Inspektoriatin e Lartë brenda datës 31 Janar të çdo viti.

Autoriteti Përgjegjës

Aneks nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(Emërtimi i institucionit)

Nr. _____ Prot.

Datë, ____/____/____

U R D H Ë R

Nr. _____, dt. ____ . ____ . ____

P Ë R
“NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Në mbështetje të nenit 41, pika 2, gërma “b” dhe nenit 42, pika 3, të ligjit Nr.9367, datë 7.4.2005
“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” I ndryshuar dhe
ligjit.....(ligji përkatës i institucionit)

URDHËROJ:

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.
2. Caktimin e:

- znj/z. _____, me detyrë _____ (drejtor i drejtorisë/njesisë së burimeve
njerëzore ; ose përgjegjës personeli; ose juristin e institucionit, etj.)

- znj/z. _____, me detyrë _____ (specifiko)

- znj/z. _____, me detyrë _____ (specifiko), si anëtarë të njesisë autoritet
përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave.

1. Drejtuesi i njesisë autoritet përgjegjës caktohet z/znj. _____. Drejtuesi i njesisë bën
ndarjen e punës mes anëtarëve.

4. Njësia e ngritur në pikën 1 të këtij Urdhri si autoritet përgjegjës do të mbajë në vijimësi kontaktet
me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

TITULLARI I INSTITUCIONIT

(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Aneks nr. 5

Administrimi i Dokumentacionit nga Autoriteti Përgjegjës Për administrimin e këtij dokumentacioni Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajë disa dosje:

1. Dosja nr. 1 me titull “Për aktet ligjore dhe nënligjore” duhet të përmbajë:

- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (i ndryshuar);
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (i ndryshuar);
- Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;
- Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligjet organike në varësi të veprimarisë së institucionit publik
- Komentaret Ligjorë të ILDKPKI-së;
- Urdhëra dhe udhëzime të ILDKPKI-së, ose të çdo institucioni tjetër të ngarkuar me ligj për këtë qëllim;
- Botime të tjera të ILDKPKI-së.

2. Dosja nr. 2 me titull “Për identifikimin dhe regjistrimin e konfliktit rast për rast të interesave” duhet të përmbajë :

- Regjistri i konfliktit rast për rast të interesave, në formë libri, i sekretuar;
- Autorizimet e plotësuara nga zyrtarët për deklarimin rast për rast të interesave;
- Deklaratat e plotësuara nga zyrtarët për konfliktin rast për rast të interesave;
- Informacionet e marra nga publiku, nga media apo nga burime të tjera të ligjshme për konfliktin rast për rast të interesave të zyrtarëve;
- Verifikimet e bëra në regjistrat publikë dhe privatë;

3. Dosja nr. 3 me titull “Për regjistrimin e deklarimeve periodike të pasurive dhe interesave të zyrtarëve që bartin detyrimim për ILDKPKI” duhet të përmbajë:

- Regjistrin themeltar alfabetik, me emrat dhe funksionet e zyrtarëve që deklarojnë në ILDKPKI;
- Kopje të njoftimeve ndaj zyrtarëve për deklarim dhe konfirmimet e tyre;
- Kopje të shkresave për deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI;
- Kopje të formularit për listën e zyrtarëve, që nuk kanë deklaruar në afat dhe shkaqet e mosdeklarimit në afat;
- Librin për dorëzimin e deklaratave të pasurisë, ku zyrtari nënshkruan për datën e dorëzimit.

Kujdes: Në rast largimi nga detyra e Autoritetit Përgjegjës, zyrtari/zyrtarët duhet të bëjnë

dorëzimin e plotë të dokumentacionit të mësipërm me procesverbal dhe inventar të detajuar, pranë Drejtorisë/ Njësisë së burimeve njerëzore, e cila më pas ia dorëzon zyrtarit/zyrtarëve të rinj.

DEKLARIM
PËR KONFLIKTIN E VAZHDESHËM TË INTERESAVE PRIVATE NGA ZYRTARI
NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK

Mbartin detyrimin për deklaram të konfliktit të vazhdueshëm të interesave private:

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndyshuar si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit publik.

Llojet e deklaramit:

- 1- Vetdeklarim para fillimit të detyrës, të ekzistencës së interesave private, të cilat bëhen shkak për lindjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesave.
- 2- Deklarim i interesave private të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror, për shkak të funksionit.

Të dhëna personale:

Emri – Atësia – Mbiemri – Funksioni – Institucioni

Lloji i deklaramit: (vendos X në kutizën për llojin e deklaramit)

- ☐ Vetdeklarim
☐ Me kërkesë

Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vertetësinë e tyre.

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave private që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
